



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE

Nr. 6374 Prot.
2

Datë 16.9.2025

Lënda: Miratim i planit të mbarështimit për pyjet dhe kullotat, Ekonomia Pyjore
"Gomsiqe"

Z.Rrok DODAJ

Kryetar

BASHKIA PUKË

Sheshi "Gjergj Kastrioti (Skënderbeu)", Pukë

I nderuar Z. Dodaj,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.989/3, datë 02.09.2026 "Kërkesë për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve, Ekonomia Pyjore "Gomsiqe". drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, bazuar në kriteret teknike e ligjore, ju bëjmë me dije se:

Struktura e planit të mbarështimit për ekonominë pyjore "Gomsiqe", me sipërfaqe të përgjithshme prej 6760 ha (4700 ha, pyll, 477 ha, sipërfaqe me bimësi pyjore, 644 ha, inproduktive, 124 ha, djerrë dhe 815 ha, kullotë e livadhe) është e bazuar në Udhëzuesin "Për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", me objektivat kryesore e specifike që orientojnë ekonominë pyjore drejt menaxhimit të duhur, duke angazhuar dhe përfshirë komunitetin për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor, në pronësi të bashkisë.

Plani i mbarështimit dhe pëmbajtja e tij, vijnë në përputhje me udhëzimet teknike e ligjore të hartimit e miratimit të tij ashtu edhe me objektivin për menaxhim të qëndrueshëm. Më konkretisht, struktura e planit të hartuar është e duhura, analiza e grumbujve pyjore me treguesit dendrometrikë është e plotë, fletët (skedat) e përshkrimit të ngastrave dhe nënngastrave përputhen me shtjellimin e tyre në plan.

Gjithashtu shtrirja gjeografike dhe vendosja e sipërfaqeve prove të përhershme në të, detajohen dhe pasqyrohen mirë. Të dhënat për moshën janë të plota, sipërfaqet pasqyrohen njëllëj, hartat e ekonomisë pyjore me rrjetin e pikave të sipërfaqeve të përhershme, tipeve të pyjeve e kullotave, funksioneve, ndërhyrjeve, rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe zonave të degraduara, janë sipas udhëzuesit.

Sa më sipër dhe bazuar në germën (b), pika 2, neni 11, të ligjit 57/2020, dat 30.4.2020, "Për pyjet", konfirmojmë për zbatim planin 10-vjeçar të mbarështimit, për ekonominë pyjore "Gomsiqe", pjesë përbërëse e fondit pyjor në pronësi të bashkisë Pukë.

Njëkohësisht duke vlerësuar hapat e ndërmarrë nga ju, lidhur me miradministrimin e fondit pyjor e kullosor, si dhe hartimin e planit të mbarështimit me fondet e vetë bashkisë, kërkojmë që struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, të bëjë përditësimet përkatëse në regjistrin e fondit pyjor dhe hedhjen e të dhënave në sistemin "ALFIS".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI

